



Prania / Datimi Formulari/Pradato Formulari/Datum		24.02.2022	2	viti god year
Organ/Institucia Organ/Institution	Nr. Prot. Pr. No.	Shtypja Printed	Sasia Kohema Quantity	
SKPM/SHCK	985/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.13/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.13/2022 të datës 12.01.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë banimi _____

kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "*kontestim konkursi*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.13/2022 e datës 12.01.2022, e parashtruar nga ankuesja _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.21/2021 i datës 10.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 07.10.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm avancim në karrierë Nr.Ref. KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-013, për pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores*" në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 07.10.2021 deri me datë 14 tetor 2021, ndërsa interesim konkurrimi kanë shprehur gjithsej tetë (8) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesen _____ Në listën e ngushtë të datës 21.10.2021 e publikuar në web faqen e Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, janë përfshirë vetëm tre (3) kandidatë: _____ dhe _____ Kurse bazuar në Njoftimin për përzgjedhje të përfundimtare të datës 08.11.2021 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, kandidati _____ është shpallur si kandidati me i suksesshëm me gjithsej 70.4 pikë.

Ankuesja e pa kënaqur më përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit me datë 06.12.2021 me numër 1822/21 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariati të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili Komision me datë 10.12.2021 merr Vendimin me numër KA.nr.21/2021 me të cilën i refuzohet ankesa e ankueses si e pa bazuar dhe mbetet në fuqi njoftimi i datës 08.11.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër KA.nr.21/2021 të datës 10.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariati të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të cilin vendim ankuesja në bazë libër ekspedicionit e ka pranuar me datë 14.12.2021 dhe me datë 12.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 76/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.01.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 19.01.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/161.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesa e datës 12.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 10.12.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Njoftimi i datës 08.11.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit; Rekomandimi për emërim i datës 05.11.2021; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.MAP-SHCK-11; Renditja përfundimtare e kandidatëve Form.MAP-SHCK-10; Formulari përmbledhës i vlerësimit individual Form.MAP-SHCK-09; Formulari i vlerësimeve individuale në intervistë me gojë i datës 02.11.2021; Regjistri i njoftimit për ardhje në testin me shkrim i datës 26.10.2021; Vlerësimi individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Përcaktimi i kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë; Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë; Raporti lidhur me listën e gushtë e datës 21.10.2021; Vlerësimet individuale për listën e ngushtë e datës 21.10.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale për listën e ngushtë e datës 21.10.2021; Deklarata për mosekzistimin e konflikt interesit e datës 21.10.2021; Testi me shkrim i datës 29.10.2021; Vendimi i datës 19.10.2021 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Kërkesa për fillimin e rekrutimit Form.MAP-SHCK-01; Libri i ekspedicionit/dëshmia e pranimit të vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave e datës 06.12.2021; Raporti javor i punës 21-25.10.2019; 28.10-01.11.2019; 25-29.01.2021; Procesverbali i shqyrtimit të ankesave i datës 07.12.2021; Shpallja e brendshme (avancim në karrierë); Aplikacioni me numër 1024 i datës 14.10.2021 me të gjithë dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me numër 982 i datës 12.10.2021 me të gjithë dokumentet e bashkangjitura si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/161.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankueses e cili ka pretenduar se kandidati i përzgjedhur për vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores" në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë, nuk e ka përvojën e punës profesionale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses nuk qëndron, pasi që sipas konkursit të datës 07.10.2021 kriteret kualifikuese për vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores" në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë, kanë qenë:

- *Diplomë e Fakultetit Juridik ose Administratë Publike dhe*
- *Minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave dëshmimeve për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe të ankueses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, listën e ngushtë e ka hartuar në pajtim me neni 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë që paragrafi 1 i këtij neni përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se, kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën e lëshuar nga Universiteti Dradania me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin Juridik, Departamenti i Kriminalistikës me datë 21.07.2012 dhe mori titullin Bachelor i Kriminalistikës, si dhe me përvojë të punës sipas vërtetimit të datës 12.10.2021 të lëshuar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore kandidati i përzgjedhur është i punësuar në vendin e punës "Zyrtar për Arkiv 2" nga data 14.12.2012-vazhdon.

Kolegji i Këshillit për shqyrtimin e ankesave, nga provat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 70.4 pikë andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paaanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe dispozitave të nenit 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariati të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.21/2021 të datës 10.12.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të



Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.13/2022**

Valentina Kaçandolli Belkateshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

